


4.3 AUTOLIVELANT

TECNOFLOOR 10



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes	54 cp/paletë	1.4 kg/m ² /mm	Gri



TECNOFLOOR 10

Autonivelant me përmbajtje të lartë çimento dhe aditivësh të modifikuar.

PËRSHKRIMI

TECNOFLOOR 10 është një autonivelant me bazë çimento, aditivë të modifikuar i cili përdoret për shtrim dhe nivelim dyshemesh. Është i klasifikuar si CT - C40 - F10 - AR2 në bazë të stadardit EN 13813.

FUSHA E APLIKIMIT

- Përdoret për përgatitjen e sipërfaqeve të lëmuara ose shtresave përpara vendosjes së materialeve si pllaka qeramike, parkete etj.
- Gjithashtu përdoret si shtresë e fundit për themele, magazina, pafingo, etj.

MËNYRA E PËRGATITJES

1. Përgatitja e suportit

Suporti duhet të jetë i pastër, pa praninë e pluhurave, pjesëve të shkëputura, vajrave, verniqeve, etj. Fillimisht, sipërfaqja trajtohet me një astar akrilik HYDROPRIMER. Produkti TECNOFLOOR 10 aplikohet mbas tharjes së plotë, afërsisht mbas dy orësh mbas aplikimit të HYDROPRIMER. Konsumimi i astarit: 200 - 300 g/m².

2. MËNYRA E APLIKIMIT

TECNOFLOOR 10 shtohet gradualisht në një sasi uji rreth 5 - 5,5L nën një përzierje të vazhdueshme deri sa të formohet një masë homogjene dhe e rrjedhshme. Përzierja lihet 3 minuta në qetesi dhe më pas përziehet përsëri. TECNOFLOOR 10 hidhet në një shtresë të vetme në sipërfaqen e paratruar me astar deri sa të arrihet trashësia e dëshiruar. Sapo produkti të jetë niveluar kalohet me një rrrul me dhëmbëza në mënyrë që të nxjerrë ajrin brenda masës së formuar. Temperatura e aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

KONSUMI

Afërsisht, 1,65 Kg/m² për mm trashësi shtresë.

PAKETIMI

TECNOFLOOR 10 është i ambalazhuar në thasë 25 Kg.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketim original dhe të pahapur. Duhet të mbrohet nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell dhe nga ngrica.



TË DHËNA TEKNIKE

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Sasia e ujit për hidratim	5-5,5 l /25 kg bag
Pesha volumore e produktit pluhur	1,40 ± 0,10 kg/l
Pesha vëllimore e llaçit të freskët	2,10 ± 0,20 kg/l
Forca shtypëse	40,00 ± 3,50 N/mm ²
Forca në përkulje	10,00 ± 1,00 N/mm ²
Forca ngjitëse	>2,0 N/mm ²
Tkurrshmëria	0,29 ± 0,10 mm/m
Jetëgjatësia e produktit të hidratuar	45-60 min at +20°C

